
 AGENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PËR TË KËRBUKUE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep.	DPK/DMP	Nr. Prot.
Dep.		Prot. No.
Nr. i hap.		Data
Broj. stranica	02	Data
Nr. pages		19.09.2013

Nr. Regj.62587/12

GJYKATA THEMELORE- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM/ DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, me gjyqtaren Vjollca Limani, në procedurën kundërvajtëse të zhvilluar kundër të pandehurit Hajdin Misin Thaqi nga fsh.Vojnik , për veprën kundërvajtëse të paraparë në nenin 5 dhe 6 paragrafi 1 pika 1 të sanksionuar sipas nenit 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit nr. 04/L-050, e në mbështetje të neneve 7, 73, 74, 195 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtje, me datë 12.09.2013, merr këtë :

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Hajdin Misin Thaqi, i lindur me 10.05.1963 në fsh.Vojnik KK Skenderaj, me vendbanim Prishtinë, rr."Agim Ramadani", 54/15, i martuar, ka të kryer fakultetin, doktor, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Kosovës,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse si zyrtar i lartë publik - UD i Drejtorit të Klinikës ORL, nuk ka bërë në afat ligjor deklarimin e pasurisë me rastin e marrjes së detyrës,

-me cka ka kryer kundërvajtjen nga neni 5 dhe 6 paragrafi 1.1 të ndëshkuar sipas nenit 17 paragrafi 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, nr.04/L-050, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet:

Q O R T I M

Nga një kopje e aktvendimit i dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës,

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, me kërkesën nr.01-4254/12 të dt.23.11.2012, ka kërkuar që të zhvillohet procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit për veprën kundërvajtëse si më lartë, përshkak se i pandehuri brenda afatit ligjor nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë me rastin e marrjes së detyrës.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjykata inicioi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit, i cili në mbrojtjen e tij deklaroi: pasi është bërë anulimi i konkursit për drejtorët e klinikave të QKUK-së, me kërkesën e Këshillit Mbikqyrës të Ankesave për Shërbyesit Civil, kam ngelur Ushtrues Detyre i Drejtorit të Klinikës ORL. Unë për obligimin e deklarimit të pasurisë jam njoftuar me dt.16.11.2012, dhe pas këtij njoftimi unë menjëherë e kam bërë deklarimin e pasurisë me datë 23.11.2012 për çka edhe posedojë vërtetimin e lëshuar nga Agjencioni Kundër Korrupsionit. Nuk kam qenë në dijeni për obligimin e deklarimit të pasurisë pasi që më parë nuk kam pasur funksione apo pozitë të lartë udhëheqëse. Shton se nga periudha e njoftimit deri në periudhën e deklarimit është marrë me sigurimin e certifikatave dhe dokumenteve të ndryshme me qëllim të provimit të gjithë pasurisë të cilën e posedon.

Lidhur me këtë çështje është dëgjuar edhe përfaqësuesi i Agjencionit Kundër Korrupsionit- Enis Sadiku, i cili deklaroi: pika kontaktuese e Ministrisë së Shëndetësisë- Haki Smajli, na ka njoftuar përmes emailit me dt.14.08.2012, me listën dhe emrat e 30 drejtorëve të Klinikës së QKUK-së, në të cilën listë bënë pjesë edhe i pandehuri Hajdin Thaqi. Habitem se si njoftimin e këtyre drejtorëve Haki Smajli e ka bërë përafërsisht 3 muaj pas njoftimit që na e ka bërë neve Agjencionit. I pandehuri deklarimin e pasurisë në AKK e ka bërë më dt. 23.11.2012, që do të thotë përafërsisht 3 muaj nga data e njoftimit që i ka bërë AKK, pika kontaktuese e Ministrisë së Shëndetësisë-Haki Smajli, andaj përshkak të mos deklarimit me kohë ndaj tij është iniciuar kërkesa për veprën kundërvajtëse të paraparë me ligjin nr.04/L-050.

Për të vërtetuar drejt gjendjen faktike është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit edhe pika kontaktuese e Ministrisë së Shëndetësisë- zyrtari Haki Dërvish Smajli, i cili deklaroi: është e vërtetë se me 14.08.2012, kam bërë një njoftim me email në Agjencionin Kundër Korrupsionit lidhur me zyrtaret publik përkatësisht

drejtoret e klinikave të cilët kanë për obligim deklarin e pasurisë. Kjo liste eshte lista prej 30 drejtoreve të cilët janë zgjedhur në bazë të konkursit të rregullt, mirpo për shkak të ndërhyrjes së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, konkursi është anuluar si i jashtëligjshëm. Kështu që në bazë të një vendimi nga drejtori ekzekutiv i QKU-ës Nijazi Gashi që është marrë me 01.10.2012 këta drejtor janë emëruar si ushtrues detyre deri në zgjedhjen e kësaj çështje. Duke i pasur këto dilema rreth emërimit të tyre dhe këto probleme lidhur me konkursin, ne edhe kemi ngelur të hutuar lidhur me përgjegjësin e tyre për deklarin apo mos deklarin të pasurisë, duke qenë se statusi i tyre nuk ishte zgjedhur përfundimisht. Këto kanë qenë arsyet që Ministria e Shëndetësisë me 15.11.2012 ka njoftuar të gjithë ushtruesit e detyrës se drejtoreve të klinikave të bëjnë deklarin e pasurisë kështu që me 16.11.2012 u janë dorëzuar edhe formularët për deklarin të pasurisë, për të cilin qëllim është mbajtur edhe një listë si dëshmi e dorëzimit të tyre nga edhe shihet që të njëjtën ditë ky formular është pranuar nga i pandehuri Hajdin Thaqi.

Me vlerësimin e deklaratës së të pandehurit, parashtruesit të kërkesës, pikës kontaktuese, analizimit të të dhënave të parashtruar në kërkesë, shqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja vërtetoi se i pandehuri ka bërë deklarin e pasurisë me 7 vonesë, (duke e llogaritur këtë nga data e njoftimit të bërë nga ana e pikës kontaktuese), andaj me këtë veprim i pandehuri ka kryer veprën kundërvajtëse ashtu si e ngarkon kërkesa, dhe për këtë është shpallur fajtor dhe është ndëshkuar konform nenit 10 të LMK, si në dispozitiv të aktvendimit, duke konsideruar se ekzistojnë rrethana që në masë të konsiderueshme e zvogëlojnë përgjegjësinë e kryesit kështu që mund pritët se edhe pa dhënien e dënimit i njëjti nuk do të përsërisë kundërvajtjen.

Me rastin e shqiptimit të ndëshkimit konform nenit 7 të LMK, gjyqtarja pati për bazë: peshën e veprës së kryer; shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit; si rrethanë lehtësuese: sjelljet e tij gjatë gjykimit; faktin se i pandehuri për herë të parë ka kryer këtë kundërvajtje; për herë të parë e ushtron një pozitë të lartë udhëheqëse dhe duke qenë kështu nuk ka qenë në dijeni për këtë obligim ligjor; vonesa prej 7 ditë në deklarin e pasurisë nuk ka rezultuar kurrfarë pasojë, gjitha këto duke qenë e bindur se me një ndëshkim të tillë do të arrihet efekti/qëllimi i ndëshkimit.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit për Divizionin e Kundërvajtjes.

